



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Duke u mbështetur në nenin 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, nenit 47 të Statutit të Komunës dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, bën këtë:

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës, që të marrin pjesë në seancën e VII- të, të punës për vitin 2014, që do të mbahet më 29.08.2014, në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës, duke filluar me punë në orën 10:00.

Kërkohet nga anëtarët e Kuvendit që të marrin pjesë në seancë, ndërsa në rast të mungesës eventuale, mungesa duhet të arsyetohet me shkrim para mbajtjes së mbledhjes.

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së.

Lidhur me këtë seancë propozohet ky:

RENDI I DITËS

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i preferencave të KPF-së të dt.14.07.2014,
4. Shqyrtimi i Procesverbalit nga Takimi me Qytetar i dt.30.06.2014 i shqyrtuar në KPF-ën e dt. 14.07.2014,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Ndryshimeve dhe Plotësimeve të Rregullores Komunale për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale/2012,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për vuarje në diskutim publik të Draft-programit trevjeçar të banimit-social për periudhën 2013-2016,
7. Shqyrtimi i Propozimit të Kryetarit të Komunës të dt. 09.07.2014 lidhur me miratimin paraprak të Vendimit për dhenje të pronës së palujtëshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër,
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Listës së ngushtë për anëtarësim në Komitetet Konsultative -nga Paneli Intervistues (sipas Vendimit të KK dhe Konkursit të shpallur),
9. Interpelanca e Drejtorit të Shëndetësisë për gjendjen në Drejtorinë e Shëndetësisë,
10. Të ndryshme.

01 Nr.06- 3603 /14
Klinë, më 16.07 2014.



KRYESUESI,
Dr. Haxhi Ibishi